



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “NDËRTIMI I PARKIMIT NË QENDËR TË FSHATIT VUNO”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45223300-9 -
Punime ndërtimi për parking,**

VLERA E FONDIT: 19 831 644,20 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e katër presje njëzet) **Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;
- NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-6 A – Sinjalistika rrugore jondriçuese.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të liçencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Bazuar në natyrën e punimeve të parashikuara në preventive, licencat e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe volumet e punimeve që do të realizohen.

Kategoria NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë kërkohet për shkak të punimeve të konsiderueshme të gjurmimit të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë gjurmim dheu me ekskavator me zinxhir, me kapacitet kovë 0.5 m³, në kanale me gjerësi mbi 2 m, në tokë të zakonshme të kategorisë IV, me ngarkim dhe shkarkim në mjet. Për objektin në fjalë parashikohet një volum i konsiderueshëm gjurmimesh, mbi 2,000 m³, çka tregon se punimet e gjurmimit nuk përbëjnë një ndërhyrje dytësore apo të kufizuar, por një proces të rëndësishëm të realizimit të objektit. Gjurmimet janë të domosdoshme për përgatitjen dhe sistemimin e terrenit, realizimin e kuotave dhe niveleve të përcaktuara në projekt, krijimin e platformës së parkimit dhe përgatitjen e bazamentit ku do të realizohen shtresat e mëtejshme konstruktive. Përveç vetë gjurmimit, këto punime shoqërohen me ngarkimin, transportin dhe menaxhimin e materialit të dalë nga gjurmimi, si dhe me sistemimin e terrenit në përputhje me projektin. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë NP-1 A lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Kategoria NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale kërkohet për shkak se punimet kryesore të objektit kanë karakter të mirëfilltë infrastrukturor dhe lidhen me ndërtimin e platformës dhe sipërfaqeve funksionale të parkimit. Në preventiv janë parashikuar punime për mbushjen e trupit të rrugës me material të germuar, përhapjen dhe ngjeshjen e tij me makineri, si dhe mbushje me çakëll dhe gur gurore. Gjithashtu parashikohen shtresa konstruktive me çakëll mbeturinë kave me trashësi 20 cm, shtresë stabilizanti me trashësi 15 cm dhe shtresë çakëlli/makadami me trashësi 10 cm. Këto shtresa përbëjnë strukturën mbajtëse dhe funksionale të sipërfaqes së parkimit dhe kërkojnë zbatim me mjete dhe teknologji të përshtatshme për punimet e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë përhapjen, profilimin, nivelimin dhe ngjeshjen e materialeve sipas parametrave të projektit.

Në kuadër të së njëjtës kategori janë parashikuar edhe punimet e shtresave asfaltike, konkretisht shtresë binderi me trashësi 5 cm dhe shtresë asfaltobetoni me trashësi 3 cm, të cilat realizohen me makineri të specializuara për shtrimin dhe ngjeshjen e materialeve asfaltike. Realizimi i këtyre shtresave kërkon përvojë dhe kapacitet profesional në punime infrastrukturore, pasi cilësia e tyre ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë, funksionalitetin, nivelimin dhe jetëgjatësinë e sipërfaqes së parkimit. Gjithashtu, preventivi përfshin struktura monolite prej betoni të klasave C12/15 dhe C20/25, si dhe furnizim dhe vendosje të hekurit të betonit të zakonshëm me diametër mbi 12 mm. Këto punime janë pjesë përbërëse të realizimit të elementeve konstruktive të objektit dhe kërkojnë kapacitet profesional për zbatimin e punimeve të betonit dhe elementeve të armuara në përputhje me projektin konstruktiv dhe specifikimet teknike. Në tërësi, kombinimi i punimeve të gjurmimit,

mbushjeve, shtresave granulare, shtresave asfaltike dhe strukturave prej betoni tregon se objekti nuk kufizohet vetëm në një shtrim sipërfaqësor, por përfshin realizimin e një strukture të plotë infrastrukturore të parkimit, duke e bërë kategorinë NP-4 A të lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës.

Kategoria NS-6 A – Sinjalistika rrugore jondriçuese kërkohet për shkak të zërit të posaçëm të preventivit që parashikon vijëzim të shiritave gjatësorë dhe anësorë me gjerësi 12 cm, me material bikomponent (sprajt). Ky punim përbën sinjalistikë horizontale jondriçuese dhe ka funksion të drejtpërdrejtë në organizimin e qarkullimit dhe përdorimit të parkimit. Nëpërmjet vijëzimeve përcaktohen hapësirat e parkimit, kufijtë e tyre dhe zonat e qarkullimit të mjeteve, duke garantuar orientimin dhe përdorimin e rregullt e të sigurt të sipërfaqes së ndërtuar. Për rrjedhojë, kërkesa për NS-6 A është e lidhur drejtpërdrejt me një zë konkret të preventivit dhe me funksionin përfundimtar të objektit.

Në përfundim, kërkesa për kategoritë NP-1 A, NP-4 A dhe NS-6 A është përcaktuar mbi bazën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet kategorive të licencimit dhe punimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës. NP-1 A mbulon komponentin e rëndësishëm të punimeve të gërmimit dhe përgatitjes së terrenit, NP-4 A mbulon punimet kryesore infrastrukturore të ndërtimit të parkimit, përfshirë formimin e trupit, shtresat konstruktive, asfaltimin dhe strukturat përkatëse, ndërsa NS-6 A lidhet me realizimin e sinjalistikës horizontale të parkimit. Për rrjedhojë, këto kërkesa synojnë të sigurojnë që operatori ekonomik që do të realizojë kontratën të disponojë kapacitetin profesional dhe teknik të nevojshëm për kryerjen e punimeve sipas projektit, standardeve teknike dhe kërkesave të përcaktuara në dokumentet e procedurës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedurë prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.*

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se ”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Përcaktimi i vlerës minimale prej 95% të vlerës limit të kontratës synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një eksperiencë reale dhe të konsoliduar në realizimin e punimeve të ngjashme, në një volum ekonomik të konsiderueshëm dhe të krahasueshëm me përmasat e kontratës objekt prokurimi. Ky nivel kërkesë është i arsyeshëm duke pasur parasysh se kontrata përfshin një kombinim të punimeve të prishjes, gërmimit, transportit, ndërtimit të shtresave konstruktive, betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve me gur natyral.

Kërkesa është vendosur duke respektuar përcaktimin ligjor sipas të cilit, për kontratat e punëve në procedurat e thjeshtuara, vlera e punëve të ngjashme të kërkuara në total gjatë pesë viteve të fundit nuk duhet të jetë më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Në rastin konkret,

kërkesa prej 95% është më e ulët se kufiri maksimal prej 100% të vlerës limit të kontratës dhe, për rrjedhojë, qëndron brenda kufirit të përcaktuar nga kuadri ligjor.

Në përputhje me përcaktimin ligjor, kriteri është konceptuar në mënyrë alternative, duke parashikuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve të përvojës së ngjashme e bën ofertën të kualifikueshme. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë kanë mundësi të dëshmojnë kapacitetin e tyre profesional ose nëpërmjet realizimit të një pune të ngjashme për një objekt të vetëm, brenda kufirit të përcaktuar përkatësisht nga legjislacioni, ose nëpërmjet realizimit të disa punëve të ngjashme, vlera monetare totale e të cilave plotëson pragun e kërkuar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune. Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruar, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kërkesa për disponimin e personelit kryesor drejtues teknik, konkretisht 1 (një) inxhinier ndërtimi dhe 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet, është përcaktuar në përputhje me natyrën, volumin, kompleksitetin dhe proceset teknologjike të punimeve që do të realizohen. Kërkesa për këto dy profile profesionale lidhet drejtpërdrejt me nevojën për drejtimin teknik, organizimin, koordinimin dhe kontrollin e punimeve gjatë gjithë fazave të zbatimit të kontratës.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier ndërtimi është e nevojshme për drejtimin dhe koordinimin teknik të punimeve të parashikuara në projekt, duke marrë në konsideratë se objekti përfshin disa procese ndërtimore të njëpasnjëshme dhe të ndërvarura. Në preventiv janë parashikuar punime të konsiderueshme gjermimi, me një volum mbi 2,000 m³, punime mbushjeje dhe ngjeshjeje të materialit të germuar, mbushje me çakëll dhe gur gurore, si dhe realizimi i disa shtresave konstruktive të parkimit, përfshirë shtresë çakëlli me trashësi 20 cm, stabilizant me trashësi 15 cm dhe shtresë çakëlli/makadami me trashësi 10 cm. Për realizimin korrekt të këtyre proceseve është i nevojshëm drejtimi nga një profesionist me formim në fushën e ndërtimit, i cili të jetë në gjendje të koordinojë zbatimin e punimeve sipas projektit, të kontrollojë përputhshmërinë e punimeve me specifikimet teknike dhe të sigurojë koordinimin ndërmjet fazave të ndryshme të zbatimit.

Roli i inxhinierit të ndërtimit është gjithashtu i rëndësishëm për punimet e asfaltimit, pasi preventivi përfshin shtresë binderi me trashësi 5 cm dhe shtresë asfaltobetonit me trashësi 3 cm, të cilat kërkojnë kontroll të përgatitjes së bazamentit, nivelimit, trashësive të projektimit dhe zbatimit të tyre sipas kërkesave teknike. Në të njëjtën kohë, preventivi përfshin struktura monolite prej betoni C12/15 dhe C20/25, si dhe vendosje të hekurit të betonit të zakonshëm me diametër mbi 12 mm. Për këto punime kërkohet kontrolli i cilësisë dhe i zbatimit të elementeve të betonit dhe armaturës në përputhje me projektin konstruktiv dhe specifikimet teknike. Për këtë arsye, prania e një inxhinieri ndërtimi si pjesë e personelit kryesor drejtues teknik është e lidhur drejtpërdrejt me kompleksitetin dhe diversitetin e punimeve të parashikuara.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet është e nevojshme për shkak të karakteristikave të punimeve të përfshira në objekt dhe veçanërisht të volumit të konsiderueshëm të gjermimeve dhe punimeve të formimit të terrenit. Realizimi i parkimit kërkon përcaktimin dhe materializimin në terren të akseve, kuotave dhe niveleve të parashikuara në projekt, si dhe kontrollin e vazhdueshëm të tyre gjatë procesit të gjermimit, mbushjes dhe ndërtimit të shtresave të parkimit. Inxhinieri topograf/gjeodet është i nevojshëm për kryerjen e rlevimeve, piketimeve dhe matjeve topografike, për përcaktimin e kuotave të gjermimit dhe mbushjes, kontrollin e niveleve të shtresave dhe verifikimin e pjerrësive dhe profileve të sipërfaqes së parkimit.

Nevoja për këtë profil bëhet veçanërisht e rëndësishme për shkak se preventivi përfshin një sërë shtresash me trashësi të përcaktuara, konkretisht 20 cm, 15 cm dhe 10 cm, të cilat duhet të realizohen mbi kuotat e përcaktuara në projekt dhe të kontrollohen gjatë zbatimit. Gjithashtu, për shtresat e binderit dhe asfaltobetonit është i nevojshëm kontrolli topografik i kuotave, niveleve, pjerrësive dhe profileve përfundimtare, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së sipërfaqes së parkimit me projektin dhe sigurimin e funksionimit të duhur të drenazhimit dhe qarkullimit të mjeteve. Për më tepër, duke qenë se objekti përfshin punime betoni dhe elemente të armuara, kontrolli topografik gjatë zbatimit shërben edhe për verifikimin e pozicionit, dimensioneve dhe kuotave të elementeve të parashikuara në projekt.

Në këtë mënyrë, inxhinieri topograf/gjeodet plotëson funksionin e inxhinierit të ndërtimit, duke siguruar që zbatimi në terren të jetë në përputhje me parametrat gjeometrikë dhe kuotat e projektit.

Për sa më sipër, kërkesa për 1 (një) inxhinier ndërtimi dhe 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet konsiderohet e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit, me volumin e konsiderueshëm të punimeve të gërmimit, ndërtimin e shtresave të infrastrukturës së parkimit, punimet e asfaltimit, strukturat prej betoni dhe armaturën, si dhe me kërkesën për kontroll të saktë të kuotave, niveleve dhe parametrave gjeometrikë të objektit. Këto kërkesa synojnë të garantojnë që punimet të drejtohen dhe kontrollohen nga personel me formimin profesional të përshtatshëm, duke siguruar zbatimin e objektit në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet përkatëse.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatëse, të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

- 2 (dy) betonues;
- 2 (dy) armaturist/hekurkthyes;
- 1 shtrues asfalti;
- 1 (një) teknik ndërtimi;
- 1 (një) manovrator (i cili mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit).

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruar, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive

të ndërtimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkohen specialistët e sipërpërmendur.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për 2 (dy) betonues lidhet drejtpërdrejt me punimet e betonimit të parashikuara në preventiv, ku përfshihen struktura monolite prej betoni C12/15 dhe struktura të holla monolite prej betoni C20/25. Punimet e betonit përbëjnë një komponent të rëndësishëm të objektit dhe kërkojnë zbatim të kontrolluar të proceseve të përgatitjes, transportit, hedhjes, shpërndarjes, vibrimit, nivelimit dhe trajtimit të betonit, sipas kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike. Disponimi i dy betonuesve siguron mundësinë e organizimit të një skuadre pune të përshtatshme për realizimin e njëkohshëm ose të njëpasnjëshëm të elementeve të ndryshme prej betoni, duke garantuar vazhdimësinë e procesit të betonimit dhe respektimin e kërkesave teknike.

Kërkesa për 2 (dy) armaturist/hekurkthyes është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë furnizim dhe vendosje të hekurit të betonit të zakonshëm me diametër mbi 12 mm. Realizimi i elementeve të betonit të armuar kërkon përgatitjen, prerjen, përkuljen, montimin dhe vendosjen e armaturës sipas diametrave, formave, dimensioneve dhe detajeve të përcaktuara në projektin konstruktiv. Për këtë arsye, prania e punonjësve të specializuar në punimet e armaturës është e nevojshme për garantimin e saktësisë së përpunimit dhe vendosjes së hekurit, si dhe për respektimin e mbulimit të armaturës, distancave, lidhjeve dhe pozicionimit të saj përpara betonimit. Kërkesa për dy punonjës është e përshtatshme për organizimin e procesit të përgatitjes dhe montimit të armaturës në mënyrë të koordinuar me punimet e betonimit.

Kërkesa për 1 (një) shtrues asfalti lidhet me punimet e asfaltimit të parashikuara në preventiv, konkretisht me realizimin e shtresës së binderit me trashësi 5 cm dhe shtresës së asfaltobetonit me trashësi 3 cm, të përhapura dhe të ngjeshura me makineri. Punimet asfaltike kërkojnë personel që njeh procesin e shtrimit dhe përhapjes së materialit asfaltik, koordinimin me asfaltoshtguesen dhe makineritë e ngjeshjes, si dhe kontrollin praktik të uniformitetit dhe trashësisë së shtresës gjatë zbatimit. Për këtë arsye, kërkesa për një punonjës të specializuar si shtrues asfalti lidhet drejtpërdrejt me zërat konkretë të preventivit dhe me nevojën për realizimin korrekt të shtresave asfaltike të parkimit.

Kërkesa për 1 (një) teknik ndërtimi lidhet me nevojën për mbështetje teknike dhe organizative gjatë realizimit të punimeve në kantier. Duke pasur parasysh se objekti përfshin procese të ndryshme dhe të ndërvarura, si gërmime me volum mbi 2,000 m³, mbushje dhe ngjeshje, realizim të shtresave granulare, punime betoni dhe betonarmeje, punime asfaltike dhe vijëzim, prania e një tekniku ndërtimi mundëson ndjekjen praktike të proceseve të punës, koordinimin e skuadrave, kontrollin e zbatimit të detajeve teknike dhe mbështetjen e stafit drejtues teknik në organizimin e

punimeve të përditshme në kantier. Ky profil shërben si një hallkë praktike ndërmjet drejtimit teknik dhe fuqisë punëtore të angazhuar në realizimin e punimeve.

Kërkesa për 1 (një) manovrator lidhet me përdorimin e makinerive të rënda dhe pajisjeve mekanike të nevojshme për realizimin e objektit. Në preventiv parashikohet gjërmim me ekskavator me zinxhir, ngarkim dhe transport i materialeve, përhapje dhe ngjeshje me makineri, si dhe realizimi i shtresave të ndryshme të parkimit me mjete dhe pajisje mekanike. Për më tepër, realizimi i shtresave asfaltike kërkon përdorimin e asfaltoshtresës dhe rullit ngjeshës. Për këtë arsye, disponimi i një manovratori të kualifikuar siguron operimin e sigurt dhe profesional të makinerive/pajisjeve për të cilat kërkohet operator i specializuar. Duke qenë se nevoja për këtë profil lidhet me përdorimin e makinerive gjatë fazave të ndryshme të zbatimit, është parashikuar që manovratori të mund të disponohet edhe nëpërmjet kontraktimit, duke i dhënë operatorit ekonomik fleksibilitet në mënyrën e sigurimit të këtij kapaciteti.

Përzgjedhja e këtyre profileve profesionale është bërë mbi bazën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet zërave të preventivit dhe specialitetit të punonjësve që kërkohen. Betonuesit dhe armaturistët lidhen me realizimin e strukturave prej betoni dhe betonarmeje, shtruesi i asfaltit me realizimin e shtresave të binderit dhe asfaltobetonit, tekniku i ndërtimit me mbështetjen dhe koordinimin teknik të proceseve në kantier, ndërsa manovratori me përdorimin e makinerive të nevojshme për gjërmimin, përpunimin, transportin, përhapjen dhe ngjeshjen e materialeve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore, për muajin Korrik 2026, prej minimalisht 10 (dhjetë) personash.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri do të vërtetohet me:

a) vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore;

b) listëpagesa e punonjësve, të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruar, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike. Ky numër përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar që punimet të zhvillohen paralelisht, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat për siguri, mjedis dhe afate. Një numër më i ulët do të detyronte operatorin të kryente proceset në mënyrë të fragmentuar, duke rritur rrezikun e vonesave, uljes së cilësisë dhe mosrespektimit të kushteve teknike të kontratës.

Kërkesa për disponimin e një fuqie punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) personash për muajin Korrik 2026 është përcaktuar në bazë të analizës së drejtpërdrejtë të zërave dhe proceseve të punës të parashikuara në preventivin e objektit “Ndërtimi i Parkimit në Qendër të Fshatit Vuno”, duke marrë në konsideratë volumin e punimeve, numrin e proceseve teknologjike, nevojën për zhvillimin e disa fronteve të punës dhe përdorimin e njëkohshëm të mjeteve dhe pajisjeve të rënda. Në veçanti, preventivi parashikon gërmime në volum mbi 2,000 m³, me ekskavator me zinxhirë, si dhe ngarkimin dhe transportimin e materialit të gërmuar. Për realizimin e këtij procesi kërkohet jo vetëm përdorimi i ekskavatorit dhe mjeteve të transportit, por edhe prania e punonjësve që kryejnë punime ndihmëse, orientimin dhe sistemimin e terrenit, kontrollin e frontit të punës dhe koordinimin e proceseve të ngarkimit, transportit dhe shkarkimit.

Në vijim, preventivi parashikon mbushje me material të gërmuar, mbushje me çakëll dhe gur gurore, si dhe realizimin e disa shtresave konstruktive, konkretisht shtresë çakëlli mbeturine kave 20 cm, shtresë stabilizanti 15 cm dhe shtresë çakëlli/makadami 10 cm, të cilat duhet të përhapen, nivelohen dhe ngjeshen me makineri. Këto procese kërkojnë personel për punimet ndihmëse, sistemimin e materialit, kontrollin e trashësive dhe niveleve, punimet manuale në skaje dhe zona të vështira për makineritë, si dhe koordinimin e punës së ekskavatorit, fadromës, grejderit, kamionëve dhe rulit ngjeshës.

Një pjesë e rëndësishme e fuqisë punëtore kërkohet për realizimin e strukturave monolite prej betoni C12/15 dhe strukturave të holla monolite prej betoni C20/25, të parashikuara në disa zëra të preventivit. Për këtë arsye, në kriterin 2.3.3 është përcaktuar disponimi i 2 betonuesve, të cilët lidhen drejtpërdrejt me këto procese. Punimet e betonimit kërkojnë gjithashtu punonjës ndihmës për përgatitjen e frontit, transportin dhe sistemimin e materialeve, vendosjen dhe përpunimin e betonit dhe përfundimin e elementeve të betonuar.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë me strukturat prej betoni lidhen edhe zërat “F.V. hekur betoni i zakonshëm $\varnothing > 12 \text{ mm}$ ”, të cilët përsëriten në preventiv. Për këtë arsye kërkohen 2 armaturistë/hekurkthyes në kriterin 2.3.3, të cilët janë të nevojshëm për prerjen, përkuljen, përgatitjen, vendosjen dhe lidhjen e armaturës së strukturave prej betonarmeje.

Po kështu, preventivi parashikon shtresë binderi me trashësi 5 cm dhe shtresë asfaltobetoni me trashësi 3 cm, të realizuara me makineri. Për këto procese është parashikuar 1 shtrues asfalti, i cili lidhet drejtpërdrejt me realizimin e shtresave asfaltike dhe bashkërendimin e punës së asfaltoshtrueses dhe rulit ngjeshës. Krahas tij nevojiten punonjës ndihmës për përgatitjen e frontit, kontrollin e skajeve dhe përfundimin e sipërfaqes.

Në kriterin 2.3.3 është parashikuar gjithashtu 1 teknik ndërtimi, i cili nevojitet për mbështetjen teknike të proceseve të zbatimit dhe koordinimin e punimeve në përputhje me projektin, kuotat, nivelet, trashësitë dhe specifikimet teknike.

Nevoja për këtë pozicion lidhet me faktin se objekti përfshin një seri të konsiderueshme procesesh të ndërvarura, ku kontrolli i secilës fazë ndikon drejtpërdrejt në realizimin e fazës pasuese.

Gjithashtu, për shkak të përdorimit të ekskavatorit me zinxhirë, fadromës, grejderit, rulit, asfaltoshtrueses dhe mjeteve të tjera të rënda, në kriterin 2.3.3 është parashikuar 1 manovrator, i cili mund të disponohet edhe nëpërmjet kontraktimit. Ky pozicion lidhet drejtpërdrejt me nevojën për operimin e makinerive të rënda të kërkuara në kriterin 2.3.5.

Në këtë mënyrë, nga kriteri 2.3.3 rezultojnë 7 punonjës të specializuar/teknikë, konkretisht 2 betonues, 2 armaturistë/hekurkthyes, 1 shtrues asfalti, 1 teknik ndërtimi dhe 1 manovrator. Këta punonjës përfaqësojnë personelin e specializuar që kërkohet drejtpërdrejt nga proceset specifike të betonimit, betonarmesë, asfaltimit dhe operimit të makinerive.

Ndërkohë, për të arritur në fuqinë minimale prej 10 personash, kërkohen edhe 3 punonjës të tjerë ndihmës/operativë, të cilët janë të nevojshëm për mbështetjen e proceseve të gërmimit, mbushjes, përhapjes dhe sistemit të materialeve, punimeve të shtresave, betonimit, armaturës, asfaltimit, montimit të parmakëve metalikë dhe vijëzimit horizontal. Këta punonjës nuk lidhen me një proces të vetëm, por shërbejnë në mënyrë fleksibël në funksion të frontit të punës që është aktiv në faza të ndryshme të zbatimit.

Përcaktimi i fuqisë minimale prej 10 personash lidhet gjithashtu me volumin e konsiderueshëm të gërmimeve, mbi 2,000 m³, dhe me numrin e mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara për realizimin e kontratës. Në kriterin 2.3.5 parashikohet disponimi i 2 kamionëve me kapacitet mbi 20 ton, 1 kamion me vinç, 1 asfaltoshtruese, 1 rul ngjeshës, 2 autobetoniera, 1 ekskavator me zinxhirë, 1 fadromë me goma, 1 betoniere kantieri, 1 gjenerator, 1 pajisje për vijëzim horizontal dhe 1 grejder. Ky konfigurim tregon se zbatimi i kontratës kërkon organizimin e disa proceseve të ndryshme dhe koordinimin e vazhdueshëm të makinerive me personelin e kantierit.

Prandaj, 10 punonjësit përbëjnë një kapacitet minimal njerëzor të arsyeshëm, i cili mund të paraqitet në mënyrë orientuese si 7 punonjës të specializuar/teknikë + 3 punonjës ndihmës/operativë. Ky numër nuk nënkupton se të gjithë punonjësit do të angazhohen në të njëjtën kohë në të njëjtin front pune, por siguron që operatori ekonomik të ketë një bazë minimale të mjaftueshme për të organizuar dhe mbështetur proceset e ndryshme të parashikuara në preventiv. Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë një strukturë minimale njerëzore të aftë për të përballuar gërmimet mbi 2,000 m³, punimet e mbushjes dhe shtresave, betonimet C12/15 dhe C20/25, punimet e armaturës Ø >12 mm, asfaltimin me binder dhe asfaltobeton, montimin e parmakëve metalikë dhe vijëzimin horizontal të parkimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet/Pajisjet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamion me vinc	1 copë	Në pronësi ose me qira
3	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qira
4	Rul ngjeshës	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Autobetonierë	2 copë	Në pronësi ose me qira
6	Eskavator me zinxhirë	1 copë	Në pronësi ose me qira

7	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
8	Betonierë kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qira
9	Gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qira
10	Pajisje/set për vijëzim horizontal bikomponent	1 copë	Në pronësi ose me qira
11	Grejder	1 copë	Në pronësi ose me qira
12	Kokore mbrojtëse	10 copë	Në pronësi ose me qira

Për mjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;
- b) leja e qarkullimit;
- c) certifikata e kontrollit teknik;
- ç) siguracioni i mjetit, i vlefshëm.

Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqiten:

- a) kontrata noteriale e qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- b) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;
- c) leja e qarkullimit;
- ç) certifikata e kontrollit teknik;
- d) siguracioni i mjetit, i vlefshëm.

Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara si të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi, duhet të paraqitet certifikata për transport mallrash të rrezikshëm, e lëshuar nga institucionet përkatëse dhe e vlefshme.

Për pajisjet teknike në pronësi duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e blerjes, si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Kur pajisjet janë marrë me qira, duhet të paraqitet:

- kontrata e qirasë;
- kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e blerjes;
- dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Për mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruar, operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara, duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme si mjeti, ashtu edhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- deklaratë për pranimin e verifikimit të mjeteve dhe pajisjeve nga Autoriteti Kontraktor në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës;
- deklaratë që mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në procedura të tjera të shpallura fituese;
- deklaratë mbi vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve, me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.

Disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruar, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë

elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zerrat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të përcaktuara në kriterin 2.3.5 është hartuar në përputhje me natyrën, volumin, kompleksitetin dhe kërkesat teknologjike të punimeve të parashikuara në preventiv. Përcaktimi i mjeteve dhe pajisjeve është bërë duke analizuar proceset konkrete të punës që do të realizohen në kantier, duke filluar nga gërmimet dhe transporti i materialeve, vijuar me formimin dhe ngjeshjen e shtresave të parkimit, realizimin e strukturave prej betoni dhe betonarmeje, punimet e asfaltimit dhe përfunduar me vijëzimin horizontal të sipërfaqes së parkimit. Disponimi i këtyre mjeteve synon të garantojë kapacitetin teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik për realizimin e punimeve brenda parametrave të projektit dhe sipas specifikimeve teknike.

Kërkesa për 2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës mbi 20 ton lidhet me volumin e konsiderueshëm të punimeve të gërmimit, i cili është mbi 2,000 m³, si dhe me nevojën për transportimin e materialit të gërmuar dhe të materialeve të nevojshme për realizimin e mbushjeve dhe shtresave të parkimit. Preventivi parashikon gërmim me ekskavator me zinxhir, me ngarkim të materialit në mjet, si dhe mbushje me material të gërmuar dhe me çakëll e gur gurore. Për më tepër, realizimi i shtresave të çakëllit, stabilizantit dhe materialeve të tjera granulare kërkon transport të vazhdueshëm të sasive

të konsiderueshme të materialeve. Kërkesa për dy kamionë me kapacitet të lartë synon të sigurojë një ritëm të përshtatshëm pune dhe të shmangë ndërprerjet e proceseve të gërmimit, furnizimit dhe përhapjes së materialeve.

Kërkesa për 1 (një) kamion me vinç lidhet me nevojën për transportimin, ngarkimin, shkarkimin dhe vendosjen e elementeve të ndryshme të parashikuara në objekt, veçanërisht të parmakëve metalikë të gatshëm, si dhe të materialeve ose elementeve që për shkak të peshës dhe përmasave kërkojnë mjete ngritëse për manipulim të sigurt. Përdorimi i një kamioni me vinç mundëson kryerjen e këtyre operacioneve në mënyrë të kontrolluar dhe redukton nevojën për mjete të tjera të posaçme ngritëse.

Kërkesa për 1 (një) asfaltoshtuese është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë realizimin e shtresës së binderit me trashësi 5 cm dhe shtresës së asfaltobetonit me trashësi 3 cm, me makineri. Asfaltoshtuesja është pajisje e nevojshme për përhapjen uniforme të materialit asfaltik dhe realizimin e trashësisë, profilit dhe nivelit të përcaktuar në projekt. Disponimi i kësaj pajisjeje siguron që punimet asfaltike të mund të realizohen në mënyrë të vazhdueshme dhe me parametrat teknikë të kërkuar.

Kërkesa për 1 (një) rul ngjeshës lidhet me proceset e ngjeshjes së materialeve të parashikuara në preventiv. Në mënyrë të veçantë, parashikohet mbushje e trupit të rrugës dhe përhapje e ngjeshje me makineri, mbushje me çakëll dhe gur gurore, shtresë çakëlli me trashësi 20 cm, shtresë stabilizanti 15 cm dhe shtresë çakëlli/makadami 10 cm. Ruli ngjeshës është i nevojshëm për arritjen e shkallës së kërkuar të ngjeshjes së këtyre shtresave dhe për sigurimin e qëndrueshmërisë së platformës së parkimit. Gjithashtu, pajisja përdoret në procesin e ngjeshjes së shtresave asfaltike pas shtrimit të tyre.

Kërkesa për 2 (dy) autobetoniera lidhet me punimet e betonimit të parashikuara në preventiv, ku përfshihen struktura monolite prej betoni C12/15 dhe struktura të holla monolite prej betoni C20/25. Autobetonierat janë të nevojshme për transportimin e betonit të gatshëm nga impianti i prodhimit deri në kantier, duke garantuar ruajtjen e karakteristikave të betonit dhe furnizimin e vazhdueshëm të frontit të punës. Kërkesa për dy mjete mundëson organizimin e furnizimit në mënyrë të vazhdueshme dhe minimizon ndërprerjet gjatë proceseve të betonimit.

Kërkesa për 1 (një) ekskavator me zinxhirë lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit për gërmim dheu me ekskavator zinxhir, me kovë 0.5 m³, në tokë të kategorisë IV. Duke pasur parasysh volumin e gërmimeve mbi 2,000 m³, ekskavatori përbën një nga makineritë kryesore për realizimin e fazës së parë të punimeve. Ai nevojitet gjithashtu për ngarkimin dhe manipulimin e materialeve të gërmuara dhe për punime të ndryshme të sistemit të terrenit.

Kërkesa për 1 (një) fadromë me goma lidhet me nevojën për ngarkimin, transportimin në distanca të shkurtra, shpërndarjen dhe sistemin e materialeve granulare të përdorura për mbushjet dhe shtresat e parkimit. Fadroma është veçanërisht e përshtatshme për punime në platformën e parkimit, ku kërkohet manipulim i vazhdueshëm i materialeve dhe organizim i frontit të punës. Përdorimi i saj plotëson funksionin e ekskavatorit dhe kamionëve, duke mundësuar një proces më të shpejtë dhe më efikas të përpunimit të materialeve.

Kërkesa për 1 (një) betoniere kantieri lidhet me mundësinë e realizimit të punimeve të vogla dhe plotësuese të betonit në kantier, të cilat mund të kërkojnë përgatitje të sasive të kufizuara të llaçit ose betonit dhe për të cilat transporti me autobetonierë nuk do të ishte praktik. Kjo pajisje mund të përdoret për punime ndihmëse dhe elemente të vogla që nuk kërkojnë furnizim nga impianti i betonit të gatshëm.

Kërkesa për 1 (një) gjenerator lidhet me nevojën për sigurimin e energjisë elektrike rezervë në kantier, veçanërisht për pajisjet dhe mjetet që përdoren gjatë fazave të ndryshme të zbatimit. Gjeneratori siguron vazhdimësinë e proceseve të punës në rast të mungesës ose ndërprerjes së furnizimit elektrik dhe mund të përdoret për pajisje të vogla, ndriçim të përkohshëm dhe procese ndihmëse të kantierit.

Kërkesa për 1 (një) pajisje/set për vijëzim horizontal bikomponent lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit që parashikon vijëzim të shiritave gjatësorë dhe anësorë me gjerësi 12 cm, me material bikomponent (sprajt). Pajisja është e nevojshme për realizimin e sinjalistikës horizontale të parkimit, për përcaktimin e hapësirave të parkimit dhe të zonave të qarkullimit të automjeteve. Përdorimi i pajisjes së përshtatshme siguron realizimin e vijëzimeve me gjerësi dhe pozicionim uniform, sipas projektit dhe kërkesave teknike.

Kërkesa për 1 (një) grejder lidhet me proceset e formimit, profilimit dhe nivelimit të platformës dhe të shtresave të infrastrukturës së parkimit. Preventivi përfshin disa shtresa të njëpasnjëshme, konkretisht çakëll mbeturine kave 20 cm, stabilizant 15 cm dhe çakëll/makadam 10 cm, të cilat duhet të përhapen dhe të profilohen në përputhje me kuotat dhe pjerrësitë e projektit përpara ngjeshjes. Grejderi është pajisje e përshtatshme për realizimin e profilimit të saktë të këtyre shtresave dhe për krijimin e sipërfaqes së rregullt mbi të cilën do të realizohen shtresat asfaltike. Kërkesa për këtë pajisje lidhet veçanërisht me nevojën për kontroll të niveleve dhe pjerrësive të platformës së parkimit.

Kërkesa për 10 (dhjetë) kokore mbrojtëse lidhet me nevojën për garantimin e kushteve të përshtatshme të sigurisë dhe mbrojtjes së punonjësve gjatë punës në kantier. Duke qenë se zbatimi i objektit përfshin përdorimin e makinerive të rënda, transportin e materialeve, punime gërmimi, betonimi, asfaltimi dhe procese të tjera me rrezik potencial për dëmtime, pajisjet individuale të mbrojtjes, përfshirë kokoret mbrojtëse, janë të nevojshme për respektimin e kërkesave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certificate:

- *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 ose ekuivalente;*
 - *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001 ose ekuivalente;*
 - *Certifikatë për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001 ose ekuivalente;*
 - *Certifikatë për kontrollin e cilësisë së proceseve të saldimit ISO 3834-2 ose ekuivalente;*
- të vlefshme dhe të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO për zërat e mallrave apo të punimeve që merr përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente lidhet me natyrën dhe diversitetin e proceseve ndërtimore të parashikuara në preventiv. Objekti përfshin punime gjurmimi me volum mbi 2,000 m³, punime mbushjeje dhe ngjeshjeje, realizimin e shtresave të ndryshme të çakëllit dhe stabilizantit, punime betoni dhe betonarmeje, si dhe shtresa asfaltike me binder dhe asfaltobeton. Për secilin prej këtyre proceseve kërkohet kontroll i materialeve, kontroll i parametrave teknikë, verifikim i trashësive dhe niveleve të shtresave, si dhe respektimi i kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike. Një sistem i menaxhimit të cilësisë sipas ISO 9001 synon të sigurojë që këto procese të organizohen, monitorohen dhe dokumentohen në mënyrë sistematike, duke përfshirë kontrollin e materialeve të përdorura, evidentimin e proceseve të punës, trajtimin e mospërputhjeve dhe verifikimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara për punimet.

Kërkesa për ISO 14001 ose ekuivalente justifikohet nga natyra e punimeve dhe ndikimi që aktivitetet e kantierit mund të kenë në mjedisin përreth. Zbatimi i objektit përfshin gjurmime në volum të konsiderueshëm, transport dhe menaxhim të materialeve të gjurmë, përdorim të materialeve granulare, çakëllit dhe gurit gurore, si dhe përdorim të makinerive të rënda, kamionëve dhe pajisjeve të asfaltimit dhe betonimit. Këto procese mund të shoqërohen me gjenerim pluhuri, zhurma, emetime nga makineritë, mbetje inerte dhe mbetje të tjera të lidhura me aktivitetin e kantierit. Për këtë arsye, kërkesa për një sistem të menaxhimit mjedisor synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë procedura të përcaktuara për identifikimin dhe kontrollin e aspekteve mjedisore të aktivitetit, menaxhimin e mbetjeve, parandalimin e ndotjes dhe minimizimin e ndikimeve negative të punimeve në mjedisin përreth.

Kërkesa për ISO 45001 ose ekuivalente lidhet veçanërisht me natyrën e punimeve dhe nivelin e ekspozimit ndaj rreziqeve në kantier. Në realizimin e objektit do të përdoren makineri të rënda, përfshirë ekskavator me zinxhirë, fadromë, kamionë, grejder, rul ngjeshës dhe asfaltoshtuese, ndërkohë që do të zhvillohen punime gjurmimi, transporti, ngarkimi dhe shkarkimi materialeve, betonimi, vendosje armature dhe asfaltimi. Këto aktivitete paraqesin rreziqe të ndryshme për punonjësit dhe kërkojnë organizim dhe masa të përshtatshme për sigurinë në punë. Një sistem i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë sipas ISO 45001 synon të sigurojë identifikimin dhe vlerësimin sistematik të rreziqeve, përcaktimin e masave parandaluese, përdorimin e pajisjeve individuale të mbrojtjes, trajnimin e punonjësve dhe monitorimin e kushteve të sigurisë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kërkesa për certifikatë për kontrollin e cilësisë së proceseve të saldimit ISO 3834-2 ose ekuivalente lidhet me natyrën e punimeve të saldimit dhe elementeve metalike të parashikuara në objektin e prokurimit. Proceset e saldimit kërkojnë kontroll të posaçëm të materialeve, procedurave dhe parametrave të saldimit, kualifikimit të personelit, kontrollit dhe inspektimit të bashkimeve të salduara, si dhe dokumentimit dhe trajtimit të mospërputhjeve. Standardi ISO 3834-2 përcakton

kërkesa gjithëpërfshirëse të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike dhe synon të garantojë që këto procese të planifikohen, kontrollohen dhe realizohen në mënyrë të dokumentuar dhe në përputhje me kërkesat teknike. Kërkesa është e rëndësishme për garantimin e integritetit, qëndrueshmërisë, sigurisë dhe jetëgjatësisë së elementeve të salduara dhe për verifikimin e përputhshmërisë së punimeve me projektin dhe specifikimet teknike. Për rrjedhojë, kërkesa për ISO 3834-2 ose ekuivalente është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të saldimit që do të realizohen.

Kërkesa për këto sisteme menaxhimi është veçanërisht e lidhur me faktin se objekti nuk përbëhet nga një proces i vetëm ndërtimor, por nga një seri procesesh të ndërruara, duke filluar nga gjurmimi dhe përgatitja e terrenit, vijuar me mbushjet, ndërtimin dhe ngjeshjen e shtresave konstruktive, realizimin e strukturave prej betoni dhe betonarmeje, asfaltimin dhe përfunduar me sinjalistikën horizontale.

Kërkesa për certifikata të vlefshme dhe të akredituara synon të sigurojë që sistemet e pretenduara të menaxhimit të jenë të verifikueshme dhe të bazuara në standarde të njohura ndërkombëtarisht.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, relacioni teknik, preventivi i punimeve, vizatimet teknike, profilet karakteristike, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin “Ndërtimi i parkimit në qendër të fshatit Vuno” janë hartuar nga projektuesi i licencuar, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, legjislationin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktet nënligjore në fuqi për projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, standardet teknike shqiptare dhe europiane, si dhe rregullat e praktikës së mirë inxhinierike.

Objekti i investimit konsiston në ndërtimin e një hapësire të re parkimi në qendër të fshatit Vuno, me qëllim sistemimin dhe funksionalizimin e territorit, krijimin e kushteve të përshtatshme për parkimin e mjeteve, përmirësimin e aksesit dhe qarkullimit, si dhe rritjen e sigurisë dhe funksionalitetit të hapësirës publike.

Hartimi i dokumentacionit teknik është mbështetur në karakteristikat e terrenit, konfigurimin ekzistues të zonës dhe zgjidhjen teknike të projektuar për ndërtimin e parkimit. Dokumentacioni përcakton mënyrën e realizimit të punimeve, parametrat teknike, materialet, shtresat konstruktive, elementet prej betoni dhe metalike, si dhe kërkesat që duhet të respektohen gjatë zbatimit të kontratës.

Referuar preventivit të punimeve, realizimi i objektit përfshin një sërë procesesh ndërtimore të lidhura dhe të varura nga njëra-tjetra, duke filluar nga punimet e gjurmimit të dheut me ekskavator me zinxhir, ngarkimi i materialit të gjërmuar në mjet, vijuar me punimet e mbushjes dhe sistemimit të terrenit, realizimin e shtresave të ndryshme rrugore, ndërtimin e strukturave prej betoni, vendosjen e armaturës, realizimin e shtresave asfaltike, montimin e elementeve mbrojtëse metalike dhe përfundimin me sinjalistikën horizontale.

Punimet e gjurmimit të dheut me ekskavator me zinxhir, me kovë 0,5 m³, në kanale me gjerësi mbi 2 m, në tokë të zakonshme të kategorisë IV, me ngarkim në mjet, janë të nevojshme për krijimin e kuotave dhe profileve të përcaktuara në projekt, për përgatitjen e bazamentit të parkimit dhe realizimin e elementeve konstruktive dhe infrastrukturore të parashikuara. Gjurmimi duhet të kryhet në mënyrë të kontrolluar, sipas kuotave dhe profileve të projektit, duke shmangur dëmtimin e elementeve ekzistuese që duhet të ruhen.

Materiali i rezultuar nga gërmimet do të ngarkohet dhe transportohet me mjete të përshtatshme, sipas organizimit të përcaktuar për kantierin dhe kërkesave të projektit. Menaxhimi i materialeve të gërmuara është pjesë e rëndësishme e procesit të zbatimit, pasi krijimi i platformës së re të parkimit kërkon sistemim të vazhdueshëm të terrenit dhe largim të materialeve të panevojshme.

Në kuadër të punimeve janë parashikuar mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, të përhapur dhe të ngjeshur me makineri, si dhe mbushje me çakull dhe gur gurore në trupin e rrugës, të përhapur dhe të ngjeshur me makineri. Këto procese janë të nevojshme për krijimin e bazamentit të qëndrueshëm të parkimit dhe për arritjen e kuotave të përcaktuara në projekt. Materialet duhet të shpërndahen në mënyrë uniforme, të nivelohen dhe të ngjeshen mekanikisht, në përputhje me kërkesat teknike dhe parametrat e projektit.

Për realizimin e strukturës së parkimit janë parashikuar shtresa konstruktive me karakteristika dhe trashësi të ndryshme, përfshirë shtresën e çakëllit me mbeturinë kave me trashësi 20 cm, shtresën e stabilizantit me trashësi 15 cm dhe shtresën e çakëllit me trashësi 10 cm, makadam, të përhapur dhe të ngjeshur me makineri. Këto shtresa kanë funksionin e krijimit të një baze të qëndrueshme dhe të aftë për të përballuar ngarkesat e shkaktuara nga qarkullimi dhe parkimi i mjeteve.

Trashësitë, materialet dhe mënyra e realizimit të shtresave janë përcaktuar mbi bazën e projektit teknik dhe kushteve të parashikuara për përdorimin e objektit. Përhapja, nivelimi dhe ngjeshja duhet të realizohen me makineri të përshtatshme, duke siguruar uniformitetin e shtresave dhe arritjen e parametrave të kërkuar të ngjeshjes. Në preventiv janë parashikuar gjithashtu struktura monolite betoni C 12/15 dhe struktura të holla monolite betoni C 20/25, të cilat lidhen me realizimin e elementeve konstruktive dhe funksionale të parkimit. Përdorimi i klasave të ndryshme të betonit është përcaktuar në funksion të kërkesave konstruktive të elementeve përkatëse dhe të projektit teknik. Betoni duhet të përgatitet, transportohet, vendoset, vibrohet dhe kurohet në përputhje me kërkesat teknike të projektit dhe standardet përkatëse, me qëllim garantimin e rezistencës, qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së elementeve të realizuara. Realizimi i strukturave prej betoni duhet të kryhet sipas dimensioneve, kuotave, seksioneve dhe detajeve konstruktive të përcaktuara në dokumentacionin teknik.

Përforcimi i strukturave prej betoni realizohet nëpërmjet zërave të preventivit për furnizimin dhe vendosjen e hekurit të betonit të zakonshëm me diametër mbi 12 mm. Armatura ka funksionin e sigurimit të kapacitetit mbajtës dhe qëndrueshmërisë së elementeve të betonit të armuar. Hekuri duhet të jetë në përputhje me diametrat, sasinë, formën e përkuljeve, hapësirat dhe mënyrën e vendosjes të përcaktuara në vizatimet dhe detajet konstruktive.

Në përfundim të shtresave bazë dhe në përputhje me zgjidhjen teknike të projektit, parashikohet realizimi i shtresave asfaltike, konkretisht shtresës së binderit me zall lavatrice, me trashësi 5 cm, të realizuar me makineri, dhe shtresës së asfaltobetonit me zall lavatrice, me trashësi 3 cm, të realizuar me makineri. Shtresa e binderit shërben si shtresë ndërmjetëse konstruktive, ndërsa shtresa e asfaltobetonit përbën shtresën përfundimtare të sipërfaqes së parkimit. Realizimi i tyre duhet të kryhet mbi një bazament të përgatitur dhe të ngjeshur, duke respektuar trashësitë, kuotat, pjerrësitë dhe parametrat teknikë të përcaktuar në projekt.

Përhapja dhe ngjeshja e materialeve asfaltike duhet të realizohen me pajisje dhe makineri të përshtatshme, në mënyrë që të sigurohet një sipërfaqe uniforme, e qëndrueshme dhe e përshtatshme për përdorimin e parashikuar të parkimit.

Në kuadër të garantimit të sigurisë së përdoruesve dhe mjeteve janë parashikuar edhe parrmakë ure metalikë të gatshëm. Këto elemente kanë funksion mbrojtës dhe duhet të vendosen në pozicionet

e përcaktuara në projekt, duke respektuar dimensionet, mënyrën e ankorimit dhe kërkesat teknike për qëndrueshmërinë e tyre.

Parmakët metalikë duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme dhe të sigurojnë mbrojtjen e nevojshme të përdoruesve dhe mjeteve në zonat ku parashikohet vendosja e tyre. Montimi dhe fiksimi duhet të kryhen në përputhje me detajet konstruktive dhe kërkesat e projektit.

Për orientimin dhe disiplinimin e qarkullimit brenda sipërfaqes së parkimit është parashikuar vijëzimi i shiritave gjatësorë dhe anësorë me gjerësi 12 cm, me bojë bikomponente (sprajt). Ky proces është i nevojshëm për përcaktimin e qartë të vendeve të parkimit, kufijve të qarkullimit dhe organizimit funksional të hapësirës.

Materiali i përdorur për vijëzim duhet të jetë i përshtatshëm për sipërfaqe asfaltike dhe për përdorim të jashtëm, duke siguruar dukshmëri, aderencë dhe qëndrueshmëri ndaj konsumimit dhe kushteve atmosferike. Vijëzimi duhet të realizohet mbi një sipërfaqe të pastër dhe të përgatitur, sipas dimensioneve dhe pozicioneve të përcaktuara në projekt.

Çdo zë i preventivit është përcaktuar mbi bazën e projektit teknik dhe matjeve përkatëse, duke specifikuar sasinë, njësinë e matjes, karakteristikat e materialeve dhe mënyrën e realizimit të procesit përkatës të punës. Preventivi përbën bazën ekonomike të procedurës së prokurimit dhe krijon kushtet që operatorët ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre mbi një bazë të njëjtë teknike dhe financiare, duke mundësuar krahasueshmërinë e tyre.

Specifikimet teknike përcaktojnë kërkesat minimale dhe funksionale për materialet dhe proceset që do të përdoren në realizimin e objektit, duke përfshirë materialet e mbushjes, çakullin, stabilizantin, materialet gurore, betonin, hekurin e betonit, materialet asfaltike, elementet metalike dhe materialet për sinjalistikën horizontale.

Materialet e përdorura duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e parashikuar, të plotësojnë kërkesat teknike të projektit dhe, sipas rastit, të shoqërohen me dokumentacionin përkatës të cilësisë dhe konformitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vizatimet teknike, profilet karakteristike dhe detajet konstruktive janë hartuar në mënyrë që të mundësojnë interpretimin e njëjtë të punimeve nga operatorët ekonomikë dhe nga personeli përgjegjës për zbatimin dhe kontrollin e tyre. Ato përcaktojnë kuotat, dimensionet, seksionet, nivelet e gërmimit dhe mbushjes, trashësitë e shtresave, elementet prej betoni, pozicionimin e armaturës, elementet metalike dhe mënyrën e organizimit të sipërfaqes së parkimit.

Përcaktimi i saktë i kuotave dhe niveleve të terrenit, thellësive të gërmimit, trashësive të shtresave konstruktive, klasave të betonit, diametrave dhe pozicionimit të armaturës, si dhe pozicionimit të parmakëve dhe vijëzimeve është i domosdoshëm për të garantuar qëndrueshmërinë, sigurinë, funksionalitetin dhe jetëgjatësinë e objektit të përfunduar.

Grafiku i ekzekutimit të punimeve është hartuar duke marrë në konsideratë varësinë teknologjike ndërmjet proceseve të ndryshme të ndërtimit. Në mënyrë të përgjithshme, punimet parashikohet të fillojnë me organizimin dhe përgatitjen e kantierit dhe më pas me gërmimet dhe përgatitjen e terrenit, vijojnë me mbushjet dhe ngjeshjen, realizimin e shtresave të çakëllit, gurit gurore dhe stabilizantit, ndërtimin e strukturave prej betoni dhe vendosjen e armaturës, realizimin e shtresave të binderit dhe asfaltobetonit, montimin e parmakëve metalikë dhe, në fazën përfundimtare, realizimin e vijëzimit të sipërfaqes së parkimit.

Kjo renditje teknologjike synon të sigurojë vijueshmërinë e punimeve, të shmangë ndërhyrjet e panevojshme ndërmjet proceseve të ndryshme dhe të krijojë kushtet për realizimin e çdo faze në përputhje me kërkesat e projektit dhe brenda afatit kontraktor.

Dokumentacioni teknik është hartuar në mënyrë që të sigurojë një kuptim të plotë dhe të njëjtë të objektit të prokurimit nga të gjithë operatorët ekonomikë, duke shmangur paqartësitë dhe interpretimet subjektive. Specifikimet teknike janë formuluar mbi baza objektive, të matshme dhe funksionale dhe nuk synojnë favorizimin e ndonjë operatori ekonomik, marke apo prodhuesi të caktuar.

Në çdo rast kur në dokumentacionin teknik përmendet ndonjë standard, produkt, material ose karakteristikë specifike, ajo duhet të kuptohet e shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Hartimi i dokumentacionit teknik është bërë në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, duke respektuar kërkesat për qartësinë, objektivitetin dhe proporcionalitetin e specifikimeve teknike dhe duke garantuar akses të barabartë për operatorët ekonomikë.

Njëkohësisht, dokumentacioni teknik është hartuar duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, përkatësisht transparencën, proporcionalitetin, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, konkurrencën efektive dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Duke qenë se realizimi i objektit përfshin disa procese teknologjike të ndërvarura, të tilla si gjurmimi dhe përgatitja e terrenit, mbushja dhe ngjeshja, realizimi i shtresave rrugore, ndërtimi i strukturave prej betoni dhe vendosja e armaturës, realizimi i shtresave asfaltike, montimi i elementeve metalike dhe vijëzimi përfundimtar, koordinimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i proceseve të punës janë të domosdoshëm për garantimin e cilësisë së punimeve.

Për këtë arsye, zbatimi i një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë është i nevojshëm për të siguruar që çdo proces pune të realizohet në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet përkatëse, veçanërisht për proceset që lidhen me ngjeshjen e shtresave, realizimin e strukturave të betonit dhe vendosjen e armaturës, si dhe për shtresat asfaltike dhe elementet përfundimtare të sigurisë dhe sinjalistikës.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike, preventivi, relacioni teknik, vizatimet, profilet, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit përbëjnë një dokumentacion teknik të plotë dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe realizimin e punimeve. Dokumentacioni përcakton qartë punimet e gjurmimit dhe ngarkimit të materialeve, mbushjet dhe ngjeshjen, shtresat e çakëllit, materialeve gurore dhe stabilizantit, strukturat monolite prej betoni, vendosjen e hekurit të betonit, shtresat e binderit dhe asfaltobetonit, montimin e parmakëve metalikë, si dhe realizimin e vijëzimit horizontal të sipërfaqes së parkimit.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni synohet garantimi i realizimit të parkimit në qendër të fshatit Vuno me cilësinë, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e kërkuar, si dhe përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike, në funksion të interesit publik dhe të qëllimit të investimit.

NJËSIA E PROKURIMIT